



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi

**Procesverbali nga mbajtja e konsultimit publik për
Qarkoren e Pare Buxhetore dhe KAB-in për vitin 2027 dhe
vitet 2028/2029**

Procesverballi për konsultimin publik lidhur me Qarkoren e Parë Buxhetore për vitin 2027 dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027–2029 mbahet me qëllim të dokumentimit zyrtar të diskutimeve, propozimeve dhe rekomandimeve të paraqitura nga qytetarët, përfaqësuesit e institucioneve publike, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e tjera të interesit. Ky proces zhvillohet në funksion të transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare në procesin e planifikimit buxhetor komunal.

Mbajtja e këtij konsultimi publik mbështetet në bazën ligjore në fuqi, përfshirë Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, të cilat përcaktojnë obligimin e komunave për të siguruar transparencë, llogaridhënie dhe përfshirje të qytetarëve në proceset e planifikimit dhe vendimmarrjes buxhetore. Në këtë kuadër, konsultimi publik përbën një mekanizëm të domosdoshëm për shqyrtimin e prioriteteve zhvillimore dhe orientimeve financiare të komunës.

Gjatë konsultimit publik u prezantuan orientimet kryesore të Qarkores së Parë Buxhetore për vitin 2027, si dhe projeksionet dhe prioritetet e Kornizës Afatmesme Buxhetore për periudhën 2027-2029. Pjesëmarrësit patën mundësi të japin komentet, sugjerimet dhe rekomandimet e tyre lidhur me investimet kapitale, shërbimet publike dhe prioritetet zhvillimore të komunës.

Të gjitha konkluzionet, komentet dhe propozimet e dala nga ky konsultim publik evidentohen në këtë procesverbal dhe do të shqyrtohen në fazat e mëtejme të përgatitjes dhe finalizimit të dokumenteve buxhetore. Ky proces dëshmon përkushtimin institucional ndaj transparencës, pjesëmarrjes qytetare dhe menaxhimit të përgjegjshëm të financave publike në nivel komunal.

Publikimet:

Publikimet janë bërë me **28:05.2026** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/06/Njoftohen-te-gjithe-banoret-e-komunes-se-Prizrenit-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-Qarkoren-e-Pare-Buxhetore-dhe-KAB-in-Shq-Tur-Bosh.pdf>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/njoftohen-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-qarkoren-e-pare-buxhetore-dhe-kab/>

Facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/1FZ5TJ6pYs/>

Memorandumi shpjegues:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/06/Memorandumi-shpjegues-per-Qarkoren-e-Pare-Buxhetore-dhe-KAB-in-per-vitet-2027-dhe-vitet-2028-2029.pdf>

Konsultimi është mbajtur në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Prizrenit dhe ka filluar në orën 10:15.

Hapjen e konsultimit publik për Qarkoren e Parë Buxhetore dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) e bëri **Ymer Berisha**, udhëheqës i Njesisë për Komunikim me Publikun. Ai theksoi se organizimi i këtyre konsultimeve është obligim ligjor dhe një mekanizëm i rëndësishëm për sigurimin e transparencës dhe përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse të komunës. Gjatë fjalës së tij, Berisha nënvizoi se konsultimet publike krijojnë mundësi që qytetarët të shprehin nevojat, prioritetet dhe propozimet e tyre lidhur me planifikimin buxhetor, duke forcuar kështu bashkëpunimin ndërmjet institucioneve komunale dhe komunitetit. Ai gjithashtu theksoi se mbajtja e këtyre takimeve është edhe kërkesë e Kryetarit të Komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, me qëllim që procesi i hartimit të buxhetit të jetë sa më transparent, gjithëpërfshirës dhe në përputhje me interesat e qytetarëve.

Prezantimin e Qarkores së Parë Buxhetore dhe të projeksioneve buxhetore për vitin 2027 e bëri Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa, **Levent Bush**. Ai paraqiti në mënyrë të përmbledhur strukturën e buxhetit komunal, duke theksuar kategoritë kryesore të shpenzimeve të planifikuara.

Sipas prezantimit, për kategorinë e pagave dhe mëditjeve janë planifikuar 33,885,952 euro, për mallra dhe shërbime 15,230,224 euro, për shpenzime komunale 1,205,299 euro, për subvencione 5,531,785 euro, ndërsa për investime kapitale 23,235,681 euro.

Drejtori Bush bëri të ditur se buxheti i përgjithshëm i Komunës së Prizrenit për vitin 2027 është planifikuar në vlerë prej 79,118,941 euro, duke synuar mbështetjen e shërbimeve publike dhe realizimin e projekteve prioritare për qytetarët.

Informacione shtesë lidhur me buxhetin për vitin 2027 prezantoi Zyrtares Kryesore Financiare, Lulzim Sylejmani. Ai theksoi se qëllimi i këtij konsultimi publik është prezantimi i shkurtër i buxhetit dhe i kufijve buxhetorë të përcaktuar sipas Qarkores së Parë Buxhetore të dërguar nga ministria kompetente.

Sylejmani bëri të ditur se pjesëmarrësit kanë në dispozicion dokumentin me ndarjet buxhetore dhe kufijtë përkatës për secilën kategori, duke shtuar se gjatë periudhës së ardhshme do të organizohen edhe takime të tjera publike, në të cilat qytetarët dhe grupet e interesit do të kenë mundësi të paraqesin kërkesat, propozimet dhe prioritetet e tyre për planifikimin buxhetor.

Ai gjithashtu nënvizoi se Komuna po përballet me vështirësi financiare për shkak të ekzekutimit të mjeteve buxhetore nga përmbaruesit privatë. Sipas tij, deri më tani nga buxheti komunal janë ekzekutuar rreth 16 milionë euro, gjë që paraqet sfidë të konsiderueshme për planifikimin dhe realizimin e projekteve dhe shërbimeve komunale.

Kërkesat e qytetarëve:

Almir Bajrami, kryetar i këshillit të fshatrave Mushnikovë, Sreckë, Gornje Sello, Prevallë kërkoj të di se çka ka ndodhur me projektin që ka të bëjë me:

- 1-Projektin në Mushnikovë (buxhetimi me pjesëmarrje) ;
- 2-Rregullimi i problemeve me rrymë për fshatrat Prevallë dhe Gornje Sello.

Shani Tanaj, kryetar i këshillit të fshatrave Mazrek, Kojush, Planej, Milaj dhe Gorozhup, kërkoj:

- 1-Rregullimin e ndriçimit publik aty ku ka nevojë në këto fshatra;
- 2-Rregullimin e kanalizimeve;
- 3-Pastrimi i rrugës që lidh fshatrat: Gjonaj-Gorozhup;
- 4-Rregullimi i mureve mbrojtës në rrugën që lidh fshatrat: Gorozhup-Planej.

Simon Veseli, kryetar i këshillit të fshatrave Velezhë, Sërbicë e Epërme, Trepetnicë, Shpenadi dhe Smaç, kërkoj:

- 1-Pastrimi i shtratit të lumit në Velezhë;
- 2-Rregullimi i rrugëve me gjatësi prej 1500 metrave për gjithë fshatrat që përfaqësoj;
- 3-Rregullimi i ndriçimit publik për gjithë fshatrat që përfaqësoj;
- 4-Rregullimi i rrugëve fushore për gjithë fshatrat që përfaqësoj.

Tringa Kasemi, kërkoj:

- 1-Si janë planifikuar të ndahen 5 milion euro nga subvencionet;
- 2-A do të ketë rritje në subvencionimin e OJQ-ve që merren kulturë.

Faik Gashi, kryetar i këshillit të fshatit Landovicë, kërkoj:

- 1-Rregullimin e ndriçimit publik;
- 2-Pastrimi i shtratit të lumit në fshat;
- 3-Kyqja në rrugën magjistrale.

Herolind Osmanollaj, kryetar i këshillit të fshatrave Gjonaj dhe Tupec, kërkoj:

Gjonaj:

- 1-Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale;
- 2-Ndërtimi i trotuareve në zonat me frekuentim të lartë të këmbësorëve;
- 3-Ndërtimi i mureve mbrojtëse në pikat ku paraqitet nevoja;

- 4-Ndërtimi i sistemit të kanalizimit fekal dhe atmosferik;
- 5-Renovimi i Qendrës Kulturore "Reshat Çoçaj";
- 6-Ndërtimi i një çerdheje publike në fshatin Gjonaj për nevojat e rajonit të Hasit;
- 7-Hartimi i projektit për komasacionin dhe zhbllokimi i rreth 100 hektarëve tokë bujqësore në pjesën jugore të fshatit Gjonaj;
- 8-Pastrimi dhe rehabilitimi i vijës ekzistuese të kullimit të tokave bujqësore në aksin Landovicë–Gjonaj.

Tupec

- 1-Zgjerimi dhe përmirësimi i ndriçimit publik;
- 2-Ndërtimi i trotuarit përgjatë SHFMU Zenun Çoçaj, për sigurinë e nxënësve dhe këmbësorëve;
- 3-Ndërtimi i sistemit të kanalizimit fekal dhe atmosferik;
- 4-Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale.

Shkëmbim Bytyqi, kryetar i këshillit të lagjes “Jeta e Re” në Prizren, kërkoj:

- 1-Gjendja jo e kënaqshme e ndriçimit publik, e cila vazhdon të mbetet problem për banorët;
- 2-Nevoja për rregullimin e disa rrugëve që edhe sot vazhdojnë të jenë në gjendje të rënduar dhe me baltë;
- 3-E kuptojmë vështirësinë financiare me të cilën po përballlet Komuna.

Në përmbyllje të konsultimit publik u theksua se, duke marrë parasysh sfidat financiare ekzistuese, po tregohet kujdes i shtuar në lidhjen e kontratave të reja. Kjo qasje synon menaxhim më të përgjegjshëm të mjeteve publike dhe shmangie të obligimeve të pa-planifikuara që mund të rëndojnë buxhetin.

Gjithashtu u rikujtua se, në përputhje me obligimet ligjore, gjatë hartimit të buxhetit duhet të përfshihen të gjitha detyrimet dhe kontratat ekzistuese, në mënyrë që të sigurohet mbulim i plotë financiar i tyre para se të planifikohen angazhime të reja. Kjo kërkesë buron nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Ligji për Ndarjet Buxhetore, të cilat përcaktojnë parimet e disiplinës fiskale dhe planifikimit buxhetor.

Po ashtu, në rastet kur lidhen kontrata për furnizime, shërbime apo investime kapitale, zbatohet edhe Ligji për Prokurimin Publik, i cili garanton që procedurat të jenë transparente, të rregullta dhe në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Konsultimi ka përfunduar në orën 11:03.

Për të siguruar transparencë dhe informim të plotë të publikut, dokumenti i Qarkores Buxhetore dhe Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) u janë shpërndarë në formë fizike të gjithë pjesëmarrësve në konsultim. Njëkohësisht, këto dokumente janë publikuar në faqen zyrtare dhe kanë qenë të qasshme për të gjithë qytetarët përmes vegëzave përkatëse:

Ueb faqen zyrtare në rubrikën konsultim publik dhe financat: <https://prizren.rks-gov.net/konsultimet-publike/> , <https://prizren.rks-gov.net/financa/> dhe <https://prizren.rks-gov.net/qarkorja-buxhetore/> :

Platformën për Konsultime Publike:

<https://konsultimet.rks-gov.net/consultations.php?InstitutionID=20528&OpenPage=0&ClosedPage=0>

Facebook:

<https://www.facebook.com/kkprizren>

Me 09.06.2026, është mbajtur konsultimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e konsultimit:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/u-mbajt-konsultim-publik-me-qytetare-per-qarkoren-e-pare-buxhetore-2027-01-kab-in-per-vitet-2027-2029/>

Procesmbajtës:

Gjafer Ponik

Haziz Krasniqi

